K.B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**

**DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE**

**SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE**

*Nr* 17616 *prot.* *Lezhë, më* 14-09-2026

**PROJEKT-V E N D I M**

**Nr. _-_, Datë 14-09-, 2026**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NUMËR 18 DATË 29.02.2024 "PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË SIPËRFAQES SË FONDIT PYJOR NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHË, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TË PARASHIKUARA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI PËR PYJET".**

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, proçedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", Udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar", pas shqyrtimit të dokumentacionit, Kryetari i Bashkisë:

**PROPOZON**

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore prej **5.54 ha**, për vendosjen e Aerogjeneratoreve + **10.7 ha** sipërfaqe pyjore për vendosjen e paneleve diellore (fotovoltaikëve) + **8.78 km** gjatësi rruge + **0.81 km** gjatësi linjë elektrike mund të jepen në përdorim dhe shtrihen në ngastrat/nëngastrat: **4a, 4b, 5, 6a, 6b, 8b, 9, 13b 14b, 15b, 16b, 17b, 18b, 19b, 20b, 21c, 22b, 23a dhe 29** në Ekonominë Pyjore **"Zadrimë"**e shtrirë në Njësinë Administrative Blinisht dhe ngastrat/nëngastrat **78, 79, 80, 81, 82 në** Ekonominë Pyjore **"Brinjat e Kreshtës"** e shtrirë në Njësinë Administrative Ungrej, sipas Raportit Teknik, bashkangjitur.
2. Afati për dhënien në përdorim do të jetë deri në 10 vjet në përputhje me Planet e Mbarështimit të dy ekonomive pyjore, me të drejtë rinovimi.

3. Vlera fillestare e qirasë në vit, përfshirë edhe infrastrukturën ndihmëse(rrugë auto dhe linja të tensionit elektrik) do të jetë **2797660(Dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind gjashtëdhjetë),** lekë e detajuar sipas zërave.
   - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **0.45 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Shkurre **X 176000 lekë/ha = 79200 lekë.**
   - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **3.01 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Tokë me bimësi pyjore **X 143000 lekë/ha = 430430 lekë.**
   - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **0.65 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Inproduktive **X 143000 lekë/ha = 92950 lekë.**
   - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **1.43 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Cungishte **X 176000 lekë/ha = 251680 lekë.**
   - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **4.3 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Tokë me bimësi pyjore **X 143000 lekë/ha = 614900 lekë.**
   - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **6.4 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Inproduktive **X 143000 lekë/ha = 915200 lekë.**
   - Segment rruge auto për tu dhënë në përdorim, **2.92 km** në kategorinë përdorimit të territorit Shkurre **X 35000 lekë/km = 102200 lekë.**
   - Segment rruge auto për tu dhënë në përdorim, **3.89 km** në kategorinë përdorimit të territorit Tokë me bimësi pyjore **X 30000 lekë/km = 116700 lekë.**
   - Segment rruge auto për tu dhënë në përdorim, **0.82 km** në kategorinë përdorimit të territorit Inproduktive **X 25000 lekë/km = 20500 lekë.**
   - Segment rruge auto për tu dhënë në përdorim, **1.15 km** në kategorinë përdorimit të territorit Cungishte **X 50000 lekë/km = 57500 lekë.**
   - Segment linje elektrike për tu dhënë në përdorim, **0.78 km** në kategorinë përdorimit të territorit Shkurre **X 145000 lekë/km = 113100lekë.**
   - Sipërfaqe linje elektrike për tu dhënë në përdorim, **0.03 km** në kategorinë përdorimit të territorit Inproduktive **X 110000 lekë/km = 3300 lekë.**
4. Proçedura për dhënien në përdorim do të zhvillohet me garë të hapur sipas akteve ligjore e nën ligjore në fuqi.
5. Shoqëria përfituese, të paguajë rehabilitimin mjedisor sipas VKM-së nr 537 datë 22.09.2021 “Për përcaktimin e kostove të përllogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i Bashkisë Lezhë.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

**KRYETARI**

**Pjerin NDREU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA LEZHË**
**DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE**
**SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE**

*Nr* 17616 *prot.*

*Lezhë, më:* 14-09-*.2026*

# RELACION

**Mbi procedurën e dhënies në përdorim të sipërfaqeve për ndërtimin e aerogjeneratorëve dhe impianteve fotovoltaike, si dhe përdorimin e rrugëve automobilistike dhe linjave elektrike**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Shoqëria **KIRAÇ GREEN ENERGY** shpk ka dorëzuar kërkesën e datës 23.07.2026 për rishikim/ndryshim të vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë numër 18 datë 29.02.2024. Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave në Drejtorinë e Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë, pasi shqyrtoi kërkesën i ka kërkuar shoqërisë plotësimin e dokumentacionit lidhur me hartat e sipërfaqeve mbi të cilat mendohet të zhvillohet parku eolik dhe fototvoltaik, përfshirë infrastrukturën ndihmëse(rrugë auto dhe linja elektrike).

Kjo shoqëri i është drejtuar Bashkisë Lezhë më një kërkesë në vitin 2024, për marrjen në përorim të disa sipërfaqeve në zonën e Zadrimës dhe Ungrejit për ndërtimin e parkut eolik dhe nëpërmjet vëndimit numër 18 datë 29.02.2024, Këshilli i Bashkisë Lezhë ka dhënë miratimin për përdorimin e sipërfaqeve të kërkuara për ndërtimin e parkut eolik. Më pas kjo shoqëri i është drejtuar Komitetit të Investimeve Strategjike për të marrë statusin e investitorit strategjik dhe me këtë rast ka ndryshuar projektin në këtë zonë, pasi ka planifikuar në ndërtojë një park të integruar energjetik për të cilin ka paraqitur studimin dhe hartën e re për vendosjen e aerogjeneratorëve, paneleve diellore, rrugëve të aksesit dhe rrjetin elektrik. Sipërfaqet e kërkuara në kërkesën e sipërcituar ndryshojnë projektin dhe lidhur me këtë fakt lind nevoja e rishikimit të vendimit të Këshillit të Bashkisë për sa i përket ndryshimit të sipërfaqeve të kërkuara dhe vlerës që rezulton nga sipërfaqet që pretendon të marrë në përdorim.

Relacioni që i bashkangjitet Projekt-Vendimit ka për qëllim paraqitjen e procedurës që duhet të ndiqet për rastet e dhënies në përdorim të sipërfaqeve të tokës dhe infrastrukturës për realizimin e projekteve në fushën e energjisë së rinovueshme, konkretisht për:

* ndërtimin dhe instalimin e aerogjeneratorëve;
* ndërtimin dhe instalimin e impianteve fotovoltaike;

* përdorimin e rrugëve automobilistike për aksesin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e impianteve;
* përdorimin e linjave elektrike për transmetimin dhe lidhjen e energjisë së prodhuar me rrjetin elektrik.

Dhënia në përdorim realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, dokumentacionin tekniko-ligjor dhe kushtet e përcaktuara në aktet administrative dhe kontraktuale përkatëse.

**2. Përshkrimi i sipërfaqeve dhe objekteve që jepen në përdorim**

Në kuadër të zhvillimit të projektit energjetik, identifikohen sipërfaqet dhe pasuritë që nevojiten për realizimin e veprës.

Në mënyrë të përmbledhur, përdorimi i tyre ndahet në këto kategori:

**a) Sipërfaqe për aerogjeneratorët 5.54ha**

Sipërfaqet e përcaktuara për instalimin e aerogjeneratorëve përdoren për vendosjen e kullave, themeleve, pajisjeve ndihmëse dhe elementeve të tjera të nevojshme për funksionimin e impiantit.

**b) Sipërfaqe për impiantet fotovoltaike 10.7 ha**

Sipërfaqet e përcaktuara për impiantet fotovoltaike përdoren për vendosjen e paneleve fotovoltaike, strukturave mbajtëse, inverterëve, kabllove, pajisjeve të transformimit dhe elementeve të tjera të nevojshme për prodhimin dhe transmetimin e energjisë elektrike.

**c) Përdorimi i rrugëve automobilistike 8.78 km**

Rrugët dhe akset e aksesit përdoren për transportin e materialeve dhe pajisjeve, realizimin e punimeve të ndërtimit, si dhe për aksesin periodik të mjeteve gjatë mirëmbajtjes dhe operimit të impianteve.

**d) Përdorimi i linjave elektrike 0.81 km**

Sipërfaqet e nevojshme për kalimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e linjave elektrike përdoren për realizimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë së prodhuar nga impiantet deri në pikën përkatëse të lidhjes me rrjetin.

**3. Procedura e dhënies në përdorim**

Procedura fillon me identifikimin e pasurive dhe sipërfaqeve të nevojshme për realizimin e projektit.

Për çdo pasuri evidentohen të dhënat identifikuese, përfshirë sipërfaqen, vendndodhjen, numrin e pasurisë dhe statusin juridik të saj.

Pas identifikimit të pasurive, kryhet verifikimi i dokumentacionit të pronësisë dhe i mundësisë ligjore për vënien e tyre në përdorim.

Në vijim, përcaktohen sipërfaqet që do të përdoren për secilin komponent të projektit, duke bërë dallimin ndërmjet:

1. sipërfaqeve për instalimin e aerogjeneratorëve;
2. sipërfaqeve për impiantet fotovoltaike;
3. sipërfaqeve/segmenteve të rrugëve për akses;
4. sipërfaqeve të nevojshme për kalimin dhe përdorimin e linjave elektrike.

Për secilën kategori përcaktohen kushtet e përdorimit, kohëzgjatja, të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe çdo detyrim financiar që rrjedh nga përdorimi i pasurisë, sipas akteve ligjore dhe administrative në fuqi.

**4. Dokumentacioni**

Në funksion të procedurës, dokumentacioni shoqërues duhet të përmbajë, sipas rastit:

* kërkesën e subjektit për vënien në përdorim të pasurive;
* dokumentacionin e identifikimit dhe regjistrimit të subjektit;
* dokumentacionin teknik të projektit;
* planvendosjen dhe hartat përkatëse;
* listën e pasurive dhe sipërfaqeve që kërkohen për përdorim;
* dokumentacionin e pronësisë/statusit juridik të pasurive;
* aktet administrative dhe lejet/autorizimet përkatëse;
* projektin e infrastrukturës elektrike;
* dokumentacionin lidhur me rrugët dhe aksesin;
* dokumentacion tjetër të kërkuar nga legjislacioni dhe institucioni kompetent.

Dokumentacioni verifikohet nga strukturat përgjegjëse përpara vijimit të procedurës së dhënies në përdorim.

**5. Përcaktimi i sipërfaqeve dhe kushteve të përdorimit**

Sipërfaqet që do të jepen në përdorim përcaktohen mbi bazën e nevojave reale të projektit dhe dokumentacionit teknik të miratuar.

Në rastin e aerogjeneratorëve dhe impianteve fotovoltaike, sipërfaqja e përdorimit duhet të përfshijë vetëm hapësirat e nevojshme për ndërtimin, instalimin, operimin dhe mirëmbajtjen e veprës.
Për rrugët automobilistike përcaktohen segmentet dhe kushtet e përdorimit, duke garantuar aksesin për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e impianteve.
Për linjat elektrike përcaktohet korridori i kalimit dhe sipërfaqet e nevojshme për vendosjen e shtyllave, kabllove dhe pajisjeve përkatëse, si dhe për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes.

**6. Kontrata/Akti i dhënies në përdorim pas zhvillimit të procedurës së garës dhe shpalljes së fituesit.**

Pas përfundimit të verifikimeve dhe plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, përgatitet akti ose kontrata përkatëse e dhënies në përdorim.

Në këtë akt përcaktohen në mënyrë të qartë:

* pasuritë dhe sipërfaqet që jepen në përdorim;
* qëllimi i përdorimit;
* kohëzgjatja;
* të drejtat dhe detyrimet e palëve;
* kushtet financiare;
* përgjegjësitë për ndërtimin dhe mirëmbajtjen;
* detyrimet për mbrojtjen e mjedisit;
* kushtet për rikthimin e sipërfaqes pas përfundimit të përdorimit;
* rastet e zgjidhjes së kontratës/aktit;
* përgjegjësitë për dëmet eventuale të shkaktuara gjatë përdorimit.

**7. Kontrolli dhe monitorimi**

Gjatë periudhës së përdorimit, subjekti duhet të respektojë destinacionin e përcaktuar të pasurisë dhe kushtet e kontratës/aktit të dhënies në përdorim.

Strukturat përgjegjëse kanë të drejtë të kontrollojnë respektimin e kushteve të përdorimit dhe zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në dokumentacionin përkatës.

Çdo ndryshim i sipërfaqes, destinacionit apo mënyrës së përdorimit duhet të bëhet vetëm në përputhje me procedurat dhe autorizimet përkatëse.

**8. Përfundime**

Nga sa më sipër, rezulton se dhënia në përdorim e sipërfaqeve për ndërtimin e aerogjeneratorëve dhe impianteve fotovoltaike, si dhe përdorimi i rrugëve automobilistike dhe linjave elektrike, duhet të realizohet mbi bazën e një procedure të dokumentuar dhe transparente.

Procedura duhet të garantojë identifikimin e saktë të pasurive, verifikimin e statusit juridik, përcaktimin e sipërfaqeve të nevojshme, respektimin e kërkesave teknike dhe mjedisore, si dhe përcaktimin e qartë të të drejtave dhe detyrimeve të palëve.

Për sa më sipër, propozohet vijimi i procedurës përkatëse për miratimin e dhënies në përdorim të pasurive dhe infrastrukturës së cituar në projekt-vendim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet administrative përkatëse.

**Baza ligjore:**
Ligji nr.139 datë 17.12.2015"Për Vetëqeverisjen vendore".
Ligji nr.8480,datë27.05.1999"Përfunksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".
Ligji nr. 107/2014 datë31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".
Ligji nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet".
VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, proçedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre".
VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".
Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".
Udhëzimit Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Përmbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar".

Duke pritur miratimin tuaj ju falenderojmë për mirëkuptimin!

**Hartoi relacionin**
**Ing. Artan PALUSHI**

**DREJTORI**
**Paulin Gjergji**

**KRYETARI**
**Pjerin NDREU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA LEZHË**
**DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE**
**SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE**

*Nr* 17614/2 *prot.* *Lezhë, më* 14 - 09 - 2026

**MIRATOHET**
**KRYETARI I BASHKISË**
**Pjerin Ndreu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË

# RAPORT
# MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË SIPËRFAQES PYJORE NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHË.

***Lloji i aktivitetit:*** *Ndërtim parku eolik dhe fotovoltaik*

Bazuar në kërkesën e datës 23.07.2026 të paraqitur nga ana e kompanisë "KIRAÇ GREEN ENERGY" për ndryshimin e vendimit numër 18 datë 09.02.2024 grupi i punës i përbërë nga **Inxh. Ardit Molla, Inxh. Blerim Rrema dhe Inxh Eralba Mirashaj** u hartua raporti mbi vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqeve pyjore që preken nga vendosja e këtyre objekteve mbi sipërfaqen e tokës, përdorimin e rrugës auto dhe linjës elektrike.

Duke filluar nga data 01.09.2026 deri në datën 09.09.2026, specialistët e pyjeve morën në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "KIRAÇ GREEN ENERGY" dhe realizuan verifikimet në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore, objekt për dhënien në përdorim të fondit pyjor bashkiak të sipërfaqes së kërkuar.

Mbështetur në kërkesën e kompanisë dhe pas verifikimit në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor rezulton se sipërfaqet e kërkuara të merren në përdorim janë **5.54 ha** për aerogjeneratorët, **10.7 ha** për fotovoltaikët. Gjatësia e rrugës që do të jepet në përdorim në funksion të vendosjes së aerogjeneratorëve dhe paneleve fotovoltaike është **8.78 km** dhe

gjatësia e linjës elektrike është **0.81km**. Sipërfaqet për vendosjen e aerogjeneratorëve e paneleve fotovoltaike, gjatësia e rrugës dhe gjatësia e linjës elektrike që do jepen në përdorim shtrihen në ngastrat si mëposhtë:

| Nr | Ngastra | Ekonomia Pyjore | Forma e Qeverisjes |
|---|---|---|---|
| 1 | 4a | Zadrimë | Sipërfaqe me bimësi pyjore |
| 2 | 4b | Zadrimë | Inproduktive |
| 3 | 5 | Zadrimë | Shkurre |
| 4 | 6a | Zadrimë | Shkurre |
| 5 | 6b | Zadrimë | Sipërfaqe me bimësi pyjore |
| 6 | 8b | Zadrimë | Shkurre |
| 7 | 9 | Zadrimë | Cungishte |
| 8 | 13b | Zadrimë | Sipërfaqe me bimësi pyjore |
| 9 | 14b | Zadrimë | Sipërfaqe me bimësi pyjore |
| 10 | 15b | Zadrimë | Sipërfaqe me bimësi pyjore |
| 11 | 16b | Zadrimë | Shkurre |
| 12 | 17b | Zadrimë | Shkurre |
| 13 | 18b | Zadrimë | Sipërfaqe me bimësi pyjore |
| 14 | 19b | Zadrimë | Sipërfaqe me bimësi pyjore |
| 15 | 20b | Zadrimë | Sipërfaqe me bimësi pyjore |
| 16 | 21c | Zadrimë | Sipërfaqe me bimësi pyjore |
| 17 | 22b | Zadrimë | Sipërfaqe me bimësi pyjore |
| 18 | 23a | Zadrimë | Shkurre |
| 19 | 29 | Zadrimë | Shkurre |
| 20 | 78 | Brinjat e Kreshtës | Inproduktive |
| 21 | 79 | Brinjat e Kreshtës | Cungishte |
| 22 | 80 | Brinjat e Kreshtës | Shkurre |
| 23 | 81 | Brinjat e Kreshtës | Cungishte |
| 24 | 82 | Brinjat e Kreshtës | Cungishte |

Përshkrimi parcelar i sipërfaqeve me objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në këtë raport teknik. Nga verifikimi në terren rezultojnë të dhënat e pasqyruara në tabelat bashkangjitur raportit teknik.

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria **"KIRAÇ GREEN ENERGY"** shpk nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverisjes dhe treguesit kryesorë të grumbujve në ngastrën pyjore si mësipër të cilat janë në pronësi të Bashkisë sipas VKM nr.433 dt.08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive" , të ndryshuar.

Proçedurat që ndiqen për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor bashkiak mbështetën në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, proçedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre" dhe në pikën 23 të Udhëzimit Nr. 1, datë 09.06.2017, të Ministrit Mjedisit, "Për rregullat e proçedurat e kërkimit shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".
Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe miratimit të akteve të tjera normative (VKB, Leje Ndërtimi), shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e kërkuar, vetëm pas lidhjes së kontratës me Bashkinë Lezhë dhe likujdimit të tarifës prej **2797660 Lekë**.
Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.

**Shuma në lekë për 1 vit konsiston në:**

a) **Vlerën e sipërfaqes së dhënë në përdorim 2384360 lekë/ha/vit**

**Kategoria Shkurre 0.45 ha x 176000 lekë/ha/vit = 79200 Lek**
**Kategoria Tokë me bimësi pyjore 7.31 ha x 143000 lekë/ha/vit = 1045330Lek**
**Kategoria Inproduktive 7.05 ha x 143000 lekë/ha/vit = 1008150Lek**
**Kategoria Cungishte 1.43 ha x 176000 lekë/ha/vit = 251680 Lek**

b) **Vlerën e përdorimit të rrugës 296900 lekë/km/vit**

**Kategoria Shkurre 2.92 km x 35000 lekë/km/vit = 102200 Lekë**
**Kategoria Tokë me bimësi pyjore 3.89 km x 30000 lekë/km/vit = 116700 Lekë**
**Kategoria Inproduktive 0.82 km x 25000 lekë/km/vit = 20500 Lek**
**Kategoria Cungishte 1.15 km x 50000 lekë/km/vit = 57500 Lek**

c) **Vlerën e përdorimit të linjës elektrike 116400 lekë/km/vit**

**Kategoria Shkurre 0.78 km x 145000 lekë/km/vit = 113100 Lekë**
**Kategoria Inproduktive 0.03 km x 110000 lekë/km/vit = 3300 Lek**

d) **Vlera e lëndës drusore që do pritet:**

Shoqëria **"KIRAÇ GREEN ENERGY"** do të paguajë fondin për rehabilitimin mjedisor, sipas VKM-së nr 537 datë 22.09.2021 "Për përcaktimin e kostove të përllogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor" të përcaktuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak.

Në këtë raport janë bërë vlerësimet e sipërfaqeve pyjore të cilat do të përdoren për parkun eolik, fotovoltaik, rrugë auto dhe linjë elektrike në Ekonomine Pyjore "Zadrimë", Njësia Administrative Blinisht, Bashkia Lezhë dhe në Ekonominë Pyjore "Brinjat e Kreshtës", Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë.

Bashkangjitur raportit, hartat, tabelat vlerësuese dhe dokumentacioni i paraqitur nga kompania.

**HARTUAN RAPORTIN**

**Inxh. Ardit Molla** **Inxh.Eralba Mirashaj** **Inxh.Blerim Rrema**

**KONTROLLUAN RAPORTIN**

**PËRGJEGJËSI**
**Inxh. Artan PALUSHI**

**DREJTORI**
**Paulin GJERGJI**

**Bashkia Lezhe**

**Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve**

**Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave**

**PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR ( sipas regjistrit kadastral)**

( Vendosje turbina per energjine eolike, panele fotovoltaike, rruge auto dhe linje elektrike )

**Tabela 1**

| ID. Prones | Ekon.Pyjore | Parc | Perb. grumb | Funksioni | Forma Qeverisjes | Te dhena te grumbullit pyjor | | | | | | | Fuqia lendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Mosha | K.D | D mes | Lart. mes | Filizeria | Nen pylli | Katet | per ha m3 | Total m3 |
| LE4100004a | Zadrime | 4a | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | _ | _ | _ | _ | _ | _ | | |
| LE4100004b | Zadrime | 4b | Shkembore | Jo prodhues | Inproduktive | | _ | _ | _ | _ | _ | _ | | |
| LE4100005 | Zadrime | 5 | shk+lis | Prodhues | Shkurre | 15 | 0.9 | 2.5 | 2 | _ | _ | _ | | |
| LE4100006a | Zadrime | 6a | shk+lis | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.8 | 2.5 | 2 | _ | _ | _ | | |
| LE4100006b | Zadrime | 6b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | _ | _ | _ | _ | _ | _ | | |
| LE4100008b | Zadrime | 8b | shk+lis | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.7 | 2.4 | 2 | _ | _ | _ | | |
| LE4100009 | Zadrime | 9 | Qarr+te tjere | Prodhues | Cungishte | 20 | 0.7 | 4.2 | 4 | _ | _ | _ | 11 | |
| LE4100013b | Zadrime | 13b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | _ | _ | _ | _ | _ | _ | | |
| LE4100014b | Zadrime | 14b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | _ | _ | _ | _ | _ | _ | | |
| LE4100015b | Zadrime | 15b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | _ | _ | _ | _ | _ | _ | | |
| LE4100016b | Zadrime | 16b | Bulger | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.3 | 2.5 | 2 | _ | _ | _ | | |
| LE4100017b | Zadrime | 17b | shk+lis | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.4 | 2.5 | 2 | _ | _ | _ | | |
| LE4100018b | Zadrime | 18b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | _ | _ | _ | _ | _ | _ | | |
| LE4100019b | Zadrime | 19b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | _ | _ | _ | _ | _ | _ | | |
| LE4100020b | Zadrime | 20b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | _ | _ | _ | _ | _ | _ | | |
| LE4100021c | Zadrime | 21c | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | _ | _ | _ | _ | _ | _ | | |
| LE4100022b | Zadrime | 22b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | _ | _ | _ | _ | _ | _ | | |
| LE4100023a | Zadrime | 23a | shk+lis | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.8 | 2.6 | 3 | _ | _ | _ | | |
| LE4100029 | Zadrime | 29 | shk+lis | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.7 | 2.3 | 2 | _ | _ | _ | | |
| LE0800078 | Brinjat e Kreshtes | 78 | Shkembore | Jo prodhues | Inproduktive | | _ | _ | _ | _ | _ | _ | | |
| LE0800079 | Brinjat e Kreshtes | 79 | Dushk | Prodhues | Cungishte | 42 | 0.5 | _ | _ | _ | _ | _ | 2.7 | 204.6 |
| LE0800080 | Brinjat e Kreshtes | 80 | shk+fr+lis | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.4 | _ | _ | _ | _ | _ | 8.8 | 226.8 |
| LE0800081 | Brinjat e Kreshtes | 81 | shk+fr+lis | Prodhues | Cungishte | 57 | 0.7 | _ | _ | _ | _ | _ | 18.4 | 929.1 |
| LE0800082 | Brinjat e Kreshtes | 82 | lis | Prodhues | Cungishte | 57 | 0.5 | _ | _ | _ | _ | _ | 31.6 | 1440.7 |

**PLOTËSOI:**

**Inxh. Ardit Molla**

**Inxh. Eralba Mirashaj**

**Inxh. Blerim Rrema**

**PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR ( sipas verifikimit ne terren)**

( Vendosje turbina per energjine eolike, panele fotovoltaike, rruge auto dhe linje elektrike )

**Tabela 1**

| ID. Prones | Ekon.Pyjore | Parc | Perb. grumb | Funksioni | Forma Qeverisjes | Te dhena te grumbullit pyjor | | | | | | | Fuqia lendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Mosha | K.D . | D mes | Lart. mes | Filizeria | Nen pylli | Katet | per ha m3 | Total m3 |
| LE4100004a | Zadrime | 4a | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | - | - | - | - | - | - | | |
| LE4100004b | Zadrime | 4b | Shkembore | Jo prodhues | Inproduktive | | - | - | - | - | - | - | | |
| LE4100005 | Zadrime | 5 | shk+lis | Prodhues | Shkurre | 15 | 0.9 | 2.5 | 2 | - | - | - | | |
| LE4100006a | Zadrime | 6a | shk+lis | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.8 | 2.5 | 2 | - | - | - | | |
| LE4100006b | Zadrime | 6b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | - | - | - | - | - | - | | |
| LE4100008b | Zadrime | 8b | shk+lis | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.7 | 2.4 | 2 | - | - | - | | |
| LE4100009 | Zadrime | 9 | Qarr+te tjere | Prodhues | Cungishte | 20 | 0.7 | 4.2 | 4 | - | - | - | 11 | |
| LE4100013b | Zadrime | 13b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | - | - | - | - | - | - | | |
| LE4100014b | Zadrime | 14b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | - | - | - | - | - | - | | |
| LE4100015b | Zadrime | 15b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | - | - | - | - | - | - | | |
| LE4100016b | Zadrime | 16b | Bulger | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.3 | 2.5 | 2 | - | - | - | | |
| LE4100017b | Zadrime | 17b | shk+lis | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.4 | 2.5 | 2 | - | - | - | | |
| LE4100018b | Zadrime | 18b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | - | - | - | - | - | - | | |
| LE4100019b | Zadrime | 19b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | - | - | - | - | - | - | | |
| LE4100020b | Zadrime | 20b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | - | - | - | - | - | - | | |
| LE4100021c | Zadrime | 21c | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | - | - | - | - | - | - | | |
| LE4100022b | Zadrime | 22b | Bimesi e ulet | Jo prodhues | Sip me bimesi | | - | - | - | - | - | - | | |
| LE4100023a | Zadrime | 23a | shk+lis | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.8 | 2.6 | 3 | - | - | - | | |
| LE4100029 | Zadrime | 29 | shk+lis | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.7 | 2.3 | 2 | - | - | - | | |
| LE0800078 | Brinjat e Kreshtes | 78 | Shkembore | Jo prodhues | Inproduktive | | - | - | - | - | - | - | | |
| LE0800079 | Brinjat e Kreshtes | 79 | Dushk | Prodhues | Cungishte | 42 | 0.5 | - | - | - | - | - | 2.7 | 204.6 |
| LE0800080 | Brinjat e Kreshtes | 80 | shk+fr+lis | Prodhues | Shkurre | 20 | 0.4 | - | - | - | - | - | 8.8 | 226.8 |
| LE0800081 | Brinjat e Kreshtes | 81 | shk+fr+lis | Prodhues | Cungishte | 57 | 0.7 | - | - | - | - | - | 18.4 | 929.1 |
| LE0800082 | Brinjat e Kreshtes | 82 | lis | Prodhues | Cungishte | 57 | 0.5 | - | - | - | - | - | 31.6 | 1440.7 |

**PLOTËSOI:**

**Inxh. Ardit Molla**

**Inxh. Eralba Mirashaj**

**Inxh. Blerim Rrema**

**Bashkia Lezhe**

**Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve**

**Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave**

**Tabela 2**

**TABELË E PËRSHKRIMIT TË SIPËRFAQES KULLOSORE**

( Vendosje turbina per energjine eolike, panele fotovoltaike, rruge auto dhe linje elektrike )

| ID Prones | Ekonomia Pyjore Kullosore | Parcela | Bimesia ne % | Sip.sipas tipit te kullotes ne ha | | | Ngarkesa ne krere qe kullosin | | | | Vlera e kullotes 000/lek | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Legum, Gram, te tjera | Dimerore | Verore | Total | Dhen | Dhi | Te trasha | Total | Ha | Total |
| | | | | | | | | | | | | |

**PLOTËSOI:**

**Inxh. Ardit Molla**

**Inxh. Eralba Mirashaj**

**Inxh. Blerim Rrema**

**Bashkia Lezhe**
**Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve**
**Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave**

**Tabela 3**

## Investime te kryera ne vite

( Vendosje turbina per energjine eolike, panele fotovoltaike, rruge auto dhe linje elektrike )

| ID Prones | Perdorimi | Ekon.pyj/ kullos | Parc | Sip total ha | Sip me punime | Viti I kryerjes punimeve | Punimi I kryer ne ha/m3 | | | Vlera investimit 000/leke |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | pyllezim | permires | sist.mal | |
| LE4100004a | Sip me bimesi | Zadrime | 4a | 45.05 | | | | | | |
| LE4100004b | Inproduktive | Zadrime | 4b | 8.27 | | | | | | |
| LE4100005 | Shkurre | Zadrime | 5 | 77.8 | | | | | | |
| LE4100006a | Shkurre | Zadrime | 6a | 59.48 | | | | | | |
| LE4100006b | Sip me bimesi | Zadrime | 6b | 16.53 | | | | | | |
| LE4100008b | Shkurre | Zadrime | 8b | 13.55 | | | | | | |
| LE4100009 | Cungishte | Zadrime | 9 | 38.76 | | | | | | |
| LE4100013b | Sip me bimesi | Zadrime | 13b | 20.21 | | | | | | |
| LE4100014b | Sip me bimesi | Zadrime | 14b | 16.71 | | | | | | |
| LE4100015b | Sip me bimesi | Zadrime | 15b | 24.15 | | | | | | |
| LE4100016b | Shkurre | Zadrime | 16b | 29.46 | | | | | | |
| LE4100017b | Shkurre | Zadrime | 17b | 19.98 | | | | | | |
| LE4100018b | Sip me bimesi | Zadrime | 18b | 25.24 | | | | | | |
| LE4100019b | Sip me bimesi | Zadrime | 19b | 6.07 | | | | | | |
| LE4100020b | Sip me bimesi | Zadrime | 20b | 7.4 | | | | | | |
| LE4100021c | Sip me bimesi | Zadrime | 21c | 15.43 | | | | | | |
| LE4100022b | Sip me bimesi | Zadrime | 22b | 7.22 | | | | | | |
| LE4100023a | Shkurre | Zadrime | 23a | 32.72 | | | | | | |
| LE4100029 | Shkurre | Zadrime | 29 | 29.52 | | | | | | |
| LE0800078 | Inproduktive | Brinjat e Kreshtes | 78 | 128.74 | | | | | | |
| LE0800079 | Cungishte | Brinjat e Kreshtes | 79 | 74.97 | | | | | | |
| LE0800080 | Shkurre | Brinjat e Kreshtes | 80 | 25.73 | | | | | | |
| LE0800081 | Cungishte | Brinjat e Kreshtes | 81 | 50.33 | | | | | | |
| LE0800082 | Cungishte | Brinjat e Kreshtes | 82 | 45.56 | | | | | | |

*Kjo tabele plotesohet nese ka pasur investime te realizuar ne vite*

**PLOTËSOI:** **Inxh. Ardit Molla**
**Inxh. Eralba Mirashaj**
**Inxh. Blerim Rrema**

**Bashkia Lezhe**
**Drejtoria e Bujqesise, Ujitjes dhe Administrimit te Pyjeve**
**Sektori i Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave**

**Tabel**

# TABELA PERMBLEDHESE E VLERESIMIT FINANCIAR

( Vendosje turbina per energjine eolike, panele fotovoltaike, rruge auto dhe linje elektrike )

**Tabela 4**

